



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P. 109/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të KVO të datës 16.02.2021 në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr.REF-80922-12-03-2020 me objekt “Shërbim i ruajtjes me roje fizike dhe me sinjal alarmi e kamera sigurie të objekteve të Spitalit Has”,-Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit 2.000.000 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 16.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has.

**Ankimues:**

“Trezhnjeva” sh.p.k.  
Lagjia “Partizani”, Pall. 90/3, Shk. 1, Ap. 1, Bajram Curri.

**Autoriteti kontraktor:**

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has  
Rruga e Spitalit, Lagjia Nr 2, Qyteti Krumë, Bashkia Has

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit nuk ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 04.12.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr.REF-80922-12-03-2020 me objekt “Shërbim i ruajtjes me roje fizike dhe me sinjal alarmi e kamera sigurie të objekteve të Spitalit Has. Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit 2.000.000 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 16.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has.

II.2. Në datën 16.12.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar sistemit të prokurimeve elektronike (SPE) rezulton se në datë 21.12.2020, autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e procedurës së prokurimit, në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. “Trezhnjeva” sh.p.k.

1.965.954,12 lekë

kualifikuar

2. “Nazeri 2000” sh.p.k.	1.965.954,12 lekë	skualifikuar
3. “Orka” sh.p.k.	1.965.954,20 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 20.10.2020, operatori ekonomik “Orka” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen si më poshtë:

*Nuk keni paraqitur Bilancet sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 për tre vitet e fundit 2017-2018-2019 me Ekspert Kontabël.*

*Nuk keni paraqitur listëpagesat dhe urdhër pagesat për muajin gusht siç kërkohet në DST pasi tre muajt e fundit i takojnë Gusht 2020, Shtator 2020, Tetor 2020, pasi muaji Nëntor 2020 ka afat ligjor deklarimi dhe pagese datën 20.12.2020 dhe procedura është zhvilluar me 16.12.2020, pra para këtij afati.*

*Formulari i ofertës ekonomike nuk është paraqitur sipas kërkesës së AK.*

II.4.1. Në datën 28.12.2020, operatori ekonomik “Orka” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Treznjeva” sh.p.k., nga procedura e prokurimit objekt ankimi me argumentat në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

*[...]Autoriteti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalore Has ka shpallur procedurën e prokurimit me objekt : "Shërbim i ruajtjes me roje fizike dhe me sinjal alarmi e kamera sigurie të objekteve të Spitalit Has. Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj. Me nr.-REF-80922-12-03-2020. Me datë 21.12.2020 nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit publik, rubrika mesazhe jemi njoftuar për refuzimin e ofertës tonë me pretendimin se :*

*Nuk keni paraqitur Bilancet sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 për tre vitet e fundit 2017-2018-2019 me Ekspert Kontabël.*

*Nuk keni paraqitur listëpagesat dhe urdhërpagesat për muajin gusht siç kërkohet në DST pasi tre muajt e fundit i takojnë Gusht 2020, Shtator 2020, Tetor 2020, pasi muaji Nëntor 2020 ka afat ligjor deklarimi dhe pagese datën 20.12.2020 dhe procedura është zhvilluar me 16.12.2020, pra para këtij afati.*

*Formulari i ofertës ekonomike nuk është paraqitur sipas kërkesës së AK.*

*Kundërshtojmë arsyet e parashtruara nga ana juaj për refuzimin e ofertës tonë për arsye se ne kemi përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara nga ana juaj në Dokumentat e tenderit për procedurën në fjalë dhe konkretisht :*

*Për kriterin : 2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar: 2.2.1- Operatori ofertues duhet të paraqesë Vërtetim nga Administrata Tatimore mbi xhiron mesatare vjetore si dhe pasqyrat financiare sipas Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 për tre vitet e fundit 2017-2018-2019. Xhiro vjetore duhet të jetë, në një vlerë jo më e vogël se 40% sa vlera e fondit limit.*

*Shoqëria jonë për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur në sistem e prokurimit elektronik vërtetimin për xhiron e tre viteve të fundit nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës Nr. T03276390 Datë, 15.12.2020, Bilancin e vitit 2017 me nr.1297 prot, me vulë të njomë nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Kukës, Bilancin e vitit 2018 me nr.820 prot me vulë të njomë nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Kukës, Bilancin e vitit 2019 me nr.1220 prot, me vulë të njomë nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Kukës. Të gjithë bilancet janë të konfirmuara dhe të pranuar nga organi kompetent dhe kanë si formën ashtu dhe përmbajtjen në konform me parashikimet e Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, artifikat e nxjerra nga AK me pretendime të ndryshme dhe në kundërshtim me kriteret e*

përcaktuara në DST nuk kanë asgjë tjetër si qëllim veç se të arrijë objektivat me dhënien e këtij tenderi subjektit të parapëlqyer.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar: 2.2.2-Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për 3 muajt e fundit shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore, dhe urdhërpagesat. Listëpagesat E-SIG25. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 6 punonjës të siguruar në muaj, 4 punonjës shërbim roje si dhe Drejtuesin Teknik dhe Administratorin.

Për plotësimin e këtij kriteri shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin si në vijim: Urdhërpagesat për muajin Shtator 2020, Tetor 2020 dhe Nëntor 2020, Listpagesat e muajit Shtator 2020, listëpagesat e muajit tetor 2020, listpagesat e muajit nëntor 2020. Pra, duke qenë se procedura e prokurimit ishte përcaktuar të zhvillohej me 16 Dhjetor 2020 i bie që tre muajt e fundit të jenë shtatori, tetori dhe nëntori 2020 për të cilat kemi përmbushur më së miri kërkesat e përcaktuara në dst, por me sa duket AK në kundërshtim të hapur me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, (i ndryshuar) konkretisht nenin 53, pika 3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlereson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. Nga sa më lart AK në vlerësimin e bërë ka shtuar muaj konkret (Gushi 2020, Shtator 2020, Tetor 2020) të papërcaktuara në dokumentet e tenderit dhe që në mënyrë kategorike nuk ishin përcaktuar në kriteret për kualifikim të procedurës së prokurimit. Dhe kjo është një shkelje flagrante e ligjit dhe akteve ligjore të Prokurimit publik duke krijuar haptas diskriminim të shoqërisë tonë me vlerësim mbi bazë kriteresh aluduese të AK.

-Formulari i ofertes ekonomike nuk është paraqitur sipas kërkesës së AK.

Në dst e publikuara në procedurën e prokurimit me objekt : "Shërbim i ruajtjes me roje fizike dhe me sinjal alarmi e kamera sigurie të objekteve të Spitalit Has. Marreveshje Kuadë - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj. Me nr.-REF- 80922-12-03-2020, AK ka publikuar shtojcën nr. 1 Formulari i Ofertës ekonomike si më poshtë :

Shtojca 1 e dst[...]

Shtojca 1 formulari i ofertes ekonomike i plotësuar nga operatori ekonomik ankimes[...]

Analizë Kosto[...]

Referojmë shtojcën 8 të dst-ve specifikimet teknike [...]

Nga një krahasim me sy të lirë shoqëria jonë ka të njëjtin format (të marrë në dst) me atë që ka publikuar AK në dokumentat standarte të tenderit për më tepër që kemi dhe një analizë të detajuar për sa i përket vlerës totale e cila sa për informacionin e AK është e sakta dhe "I preferuari juaj" subjekti trezhnjëva sh.p.k. ka ofertuar nën koston ligjore të lejuar dhe si i tillë duhet të ishte skualifikuar pasi ashtu e kemi përcaktuar në shtojcën 1 (Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomikë ku zërat e koston në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesa mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen), ka një mënyrë që mund ta bëjë të kualifikuar subjektin tuaj dhe ajo është "gabimi njerëzor" siç ndodhi në procedurën e prokurimit me numër reference REF-73818-10-02- 2020 me objekt "Shërbimi i ruajtjes me roje fizike dhe me sinjal alarmi e kamera sigurie të objektit të Spitalit Has", i cili do zhvillohej në datën 02.12.2020 ora 13:00, për arsye të një gabimi teknik që ka ndodhur gjatë procesit të heqjes së procedurës së prokurimit nga pezullimi, e organizuar nga ana juaj e trajtuar dhe në KPP me vendimin K.P.P 507/2020, datë 06.11.2020.

Në lidhje me ofertën e ofruar nga subjekti Trezhnjëva sh.p.k në vlerën 1965954.12 Lekë pa tvsh informojmë AK se kjo vlerë e ofruar nga ky operator është nën koston e lejuar ligjore pasi nuk kanë parashikuar sipas dispozitave ligjore pagën, shtesën mbi pagë për turnin e dytë e të tretë dhe

*Sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe si e tillë duhej të ishte skualifikuar por AK duke qenë se e ka në preferencë i duket krejt normale kualifikimi i një ofertë në kundërshtim me ligjin. Për këtë po ju rikujtojmë AK se :*

*Paga bazë për një roje në muaj është= 39 000 lekë në muaj për roje/ 174 orë pune në muaj= 224.13 lekë për orë.*

*Në nenin 81 të "Kodit të Punës" është parashikuar: "Çdo ore pune e kryer nga ora 19:00 deri në orën 22:00 jep të drejtën e një shtese mbi page jo më pak se 20 % çdo ore pune e kryer midis intervalit 22:00 dhe 06:00 jep të drejtën e një shtese mbi page jo më pak se 50 %"*

*Shtesa Turni II*

*30.41 ditë mesatarisht në muaj x 3 ore Turni II-të (ora 19°00 -22°00 sipas Nenit 81 të Kodit të Punës) x 224.13 lekë/roje x 20% (shtesa sipas Nenit 81 të Kodit të Punës)x 1 vendroje./ 3.32 roje = 1231.76 lekë në muaj për roje 30.41 ditë mesatarisht në muaj x 2 orë Turni II-të (ora 22:00 - 24:00 sipas Nenit 81 të Kodit të Punës)x 224.13 lekë/ roje x 50% (shtesa sipas Nenit 81 të Kodit të Punës) x1 vendroje/ 3.32 roje = 2052.94 lekë në muaj për roje.*

*Numri i rojeve është i mjaftueshëm për të mbuluar shërbimin e kërkuar, për ditët e pushimit javor dhe ditët e festave zyrtare.*

*Total paga + shtesat = 39000 lekë + 1231.76 ) lekë + 2052.94 lekë = 42 284.7 lekë në muaj për roje. Referuar pikës Ill.3 të VKM-së nr.1114, dt.30.07.200 "Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, dt.11.05.199 "Për sigurimet shoqërore në RSH", Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit të jetë 16.7 % dhe pjesa e të punësuarit 11.2%".*

*Sigurimet = 42 284.7 lekë x 16.7 %= 7061.54 lekë në muaj për roje*

*Total paga + shtesat + sigurimet = 49 346.24 lekë për roje/muaj pa Tvsh.*

*Udhëzim Nr.264/1, datë 29.06.2015 "Për masën Kriteret dhe procedurat për tarifatat financiare për veprimtarinë e lejuar me armët"*

*Shoqëria jonë ka në pronësi të saj armët si rezultat*

*Shpenzime armatimi= 0.0001 lekë/ditë*

*Në bazë të Vendimit Nr.1490 të Ministrisë të Rendit Publik dt.21.06.2010 "Për Uniformat"*

*Shpenzime për veshëmbathje (uniforme), admin etj.= 0.0001 lekë/muaj*

*Ndërlidhje=0.0001 lekë/muaj*

*Fitimi= 0.0001 lekë/muaj*

*Shpenzime për sinjal alarmi e karkera sigurie = 0.0001 lekë*

*Total për 1 roje në muaj = 49 346.24 lekë/muaj pa Tvsh*

*Total për 1 vendroje në muaj =49 346.24 lekë/muaj për roje x 3.32 roje= 163 829.51 lekë në Muaj pa Tvsh*

*Vlera Totale për 12 muaj për 1 vendroje = 49 346.24 lekë I muaj për roje x 3.32 roje x 1 vendroje x 12 muaj = 1 965 954.2 lekë pa Tvsh.*

*Sa për ti rikujtuar AK së ligji është i njëjtë për të gjithë referojuni vendimit të K.P.P.*

*282/2019, në të cilin i preferuari juaj ka përlllogaritur ndryshe shtesën mbi page për turnin e dytë e të tretë dhe Sigurimet shoqërore e shëndetësore. I rikujtojmë AK se do ndjekim çdo rrugë ligjore administrative dhe penale për zbatimin e plotë të ligjit pasi kemi të drejtën tonë ligjore për pasjen e një procesi të barabartë, jo diskriminues dhe të trajtimit me sa me korrektësi të procedurave të prokurimit publik nga ana juaj pasi "gabimi njerezor" nuk do gjejë me mbështetje nga asnjë organ shtetëror.*

*Nga sa më lart kerkojmë nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has :*

1. *.Pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës tonë.*
2. *Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në të cilin padrejtësisht dhe në kundërshtim të hapur me ligjin kanë bërë skualifikimin e shoqërisë tonë , pasi e shprehur dhe nga vetë Spitali Has me anë të vlerësimit, në si subjekt kemi përmbushur të gjitha kriteret teknike, ligjore dhe çdo kriter tjetër të kërkuar nga AK për këtë procedurë prokurimi.*
3. *Rivlererimin e procedurës së prokurimit duke bërë korrigjimet e duhura në vlerësimin e gabuar dhe tendencioz të KVO-së, pasi përdorimi i kriterëve të pa përcaktuara në DST është në kundërshtim të hapur me Ligjin Për Prokurimin Publik, kualifikimin e shoqërisë tonë "ORKA"sh.p.k*
4. *Skualifikimin e shoqërisë "Trezhnjeva" sh.p.k. pasi ka ofertuar nën koston ligjore të lejuar.[...]*

II.4.2. Në datën 03.01.2021, me shkresën nr. 556/3 prot, operatori ekonomik “Orka” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me pranimin pjesërisht të ankesës së paraqitur prej tij në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë vijon:

*[...]Referuar relacionit të paraqitur me datë 03.01.2021 nga zyrtari i shqyrtimit të ankesave “Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ORKA sh.p.k.*

**KONSTATOVA:**

*Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ORKA se*

1. *Shoqëria jonë për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur në system e prokurimit elektronik vërtetimin për xhiron e tre viteve të fundit nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës Nr.T03276390 datë 15.12.2020, bilancin e vitit 2017 me nr.1297 prot, me vulë të njomë nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Kukës, Bilancin e vitit 2018 me nr. 820 prot me vulë të njomë nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Kukës, Bilancin e vitit 2019 me nr. 1220 prot, me vulë të njomë nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Kukës. Të gjithë bilancet janë të konfirmuara dhe të pranuar nga organi kompetent dhe kanë si formën ashtu dhe përmbajtjen në konform me parashikimet e Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, artificat e nxjerra nga AK me pretendime të ndryshme dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST nuk kanë asgjë tjetër si qëllim vetëm se të arrijë objektivat me dhënien e këtij tenderi subjektivit të parapëlqyer.*

*Zyrtari i Shqyrtimit të Ankesës pasi u njoh me dokumentat e paraqitur në SPE nga operatori ekonomik “ORKA” sh.p.k., rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur pasqyrat financiare të viteve 2017, 2018 dhe 2019. Pasqyrat financiare plotësojnë kushtet për të pasur një raport auditimi Ligjor nga ekspert kontabël ose shoqëri audituese, të cilat në fakt nuk e kanë. Me qenë se këto pasqyra financiare janë të marra në dorëzim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, vlerësojmë se operatori ekonomik për këtë pikë duhet të kualifikohet. Prandaj Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të marrë parasysh këtë vlerësim dhe të bëjë korrigjimin e nevojshëm.*

2. *Për plotësimin e këtij kriteri shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin si në vijim: Urdhërpagesat për muajin Shtator 2020, Tetor 2020 dhe Nëntor 2020, Listpagesat e muajit Shtator 2020, listpagesat e muajit tetor 2020, listëpagesat e muajit Nëntor 2020. Pra duke qenë se procedura e prokurimit ishte përcaktuar të zhvillohej me 16 dhjetor 2020 i bie që tre muajt e fundit të jenë shtatori, tetori dhe nëntori 2020 për të cilat kemi përmbushur më së miri kërkesat e përcaktuara në dst, por me sa duket AK në kundërshtim të hapur me ligjin*

Nr. 9643, datë 20.11.2006 (i ndryshuar), konkretisht nenin 53 pika 3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. Nga sa më lart AK në vlerësimin e bërë ka shtuar muaj konkret (Gusht 2020, Shtator 2020, Tetor 2020) të pa përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe që në mënyrë kategorike nuk ishin përcaktuar në kriteret për kualifikim të procedurës së prokurimit dhe kjo është një shkelje flagrante e ligjit dhe akteve ligjore të Prokurimit publik duke krijuar haptas diskriminim të shoqërisë tonë me vlerësim mbi bazë kriteresh aluduese të AK.

Zyrtari i Shqyrtimit të Ankesës pasi u njoh me dokumentet e paraqitur në SPE nga operatori ekonomik "ORKA" sh.p.k., rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur listëpagesat e muajit shtator 2020, tetor 2020 si dhe nëntor 2020. Nga pikëpamja e afateve të deklarimit dhe pagesës së listëpagesave, duke qenë se afati i fundit për pranimin e ofertave është datë 16.12.2020, tre muajt e fundit llogariten muaji gusht 2020 me afat deklarimi dhe pagese datën 20.09.2020, muaji shtator 2020 me afat deklarimi datën 20.10.2020 si dhe muaji tetor 2020 me afat deklarimi datën 20.11.2020. Muaji nëntor 2020 ka afat deklarimi dhe pagese datën 20.12.2020 dhe duke qenë se afati i fundit për pranimin dhe hapjen e ofertave është data 16.12.2020 pra është e pambyllur si periudhë nuk futet në tre muajt e fundit. Duke u nisur nga fakti që operatori ekonomik ka paraqitur listëpagesa të paguara për periudhën shtator 2020, tetor 2020 si dhe nëntor 2020, vlersojmë se operatori ekonomik për këtë pikë duhet të kualifikohet. Prandaj Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të marrë parasysh këtë vlerësim dhe të bëjë korrigjimin e nevojshëm.

3. Nga një krahasim me sy të lirë shoqëria jonë ka të njëjtin format (të marrë në dst) me atë që ka publikuar AK në dokumentat standarte të tenderit për më tepër që kemi dhe një analizë të detajuar për sa i përket vlerës totale e cila sa për informacionin e AK është e sakta dhe "I preferuari juaj" subjekti Trezhnjeva sh.p.k. ka ofertuar nën koston ligjore të lejuar dhe si i tillë duhet të ishte skualifikuar pasi ashtu e keni përcaktuar në shtojcën I (Çdo ofert e paraqitur nga operatorët ekonomikë ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesa mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar do të skualifikohen), ka një mënyrë që mund ta bëjë të kualifikuar subjektin tuaj dhe ajo është "gabimi njerezor" siç ndodhi në procedurën e prokurimit me numër reference REF-73818-10-02-2020 me objekt "Shërbimi i ruajtjes me roje fizike dhe me sinjal alarmi e kamera sigurie të objektit të Spitalit Has", i cili do zhvillohej në datën 02.12.2020 ora 13:00, për arsye të një gabimi teknik që ka ndodhur gjatë procesit të heqjes së procedurës së prokurimit nga pezullimi e organizuar nga ana juaj e trajtuar dhe në KPP me vendimin K.P.P 507/2020 datë 06.11.2020.

Zyrtari i Shqyrtimit të Ankesës pasi u njoh me dokumentet e paraqitur në SPE nga operatori ekonomik "ORKA" sh.p.k., rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur formularin e ofertës ekonomike, si dhe analizën e kostos. Zyrtari i Shqyrtimit të Ankesës konstaton se formularin e ofertës ekonomike, operatori ekonomik "ORKA" sh.p.k. nuk e ka plotësuar sipas kërkesës së AK, në kolonën e 5 (çmimi për njësi) duhej të plotësonte çmimin mujor për vend-roje (163,829.51) që të dilte çmimi në total ai që ka deklaruar, në fakt operatori ekonomik në

kolonën 5 ka plotësuar çmimin për një roje (49346.24) që po të shumëzohet me sasinë (12) çmimi total del 592,154.88 lekë. Pra, formulari i ofertës ekonomike nuk është plotësuar në rregull. Duke u nisur nga fakti që operatori ekonomik ka paraqitur analizën e kostos ku ka argumentuar koston për një vend roje /muaj, vlerësojmë se operatori ekonomik për këtë pikë duhet të kualifikohet. Prandaj Komisioni i Vlersimit të Ofertave duhet të marrë parasysh këtë vlerësim dhe të bëjë korigjimin e nevojshëm.

Në lidhje me ofertën e ofruar nga subjekti "Trezhnjeva" sh.p.k. në vlerë 1.965.954,12 lekë pa TVSH informojmë AK se kjo vlerë e ofruar nga ky operator ekonomik është nën koston e lejuar ligjore pasi nuk kanë parashikuar sipas dispozitave ligjore pagën, shtesën mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe si e tillë duhej skualifikuar por AK duke qenë se e ka në preferencë i duket krejt normale kualifikimi në kundërshtim me ligjin.

Zyrtari i Shqyrtimit të Ankesës pasi u njoh me dokumentat e paraqitur në SPE nga operatori ekonomik "Trezhnjeva" sh.p.k., rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur formularin ofertës ekonomike sipas shtojcës 1, së bashku me analizën e kostos sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Rezulton se oferta e llogaritur dhe paraqitur nga operatori ekonomik "Trezhnjeva" shpk nuk është nën koston ligjore. Duke u nisur nga kërkesa e Autoritetit Kontraktor që llogaritja e zërave të mos kalojë dy shifra pas presjes dhjetore rezulton se përllogaritja e vlerës së ofertës ekonomike nga "Trezhnjeva" shpk është e saktë pra kemi 49,346.24 lekë shumëzuar me 3.32 roje del baraz me 163,829.51 lekë/muaj shumëzuar me 12 muaj baraz më 1.965,954.12 lekë. Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.[...]

II.4. Në datën 06.01.2020, pala ankimuese operatori ekonomik "Orka" sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me argumentat në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

[...] Autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has ka shpallur procedurën e prokurimit me objekt : "Shërbim i ruajtjes me roje fizike dhe me sinjal alarmi e kamera sigurie të objekteve të Spitalit Has. Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj. Me nr.-REF-80922-12-03-2020. Me datë 21.12.2020 nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit publik, rubrika mesazhe jemi njoftuar për refuzimin e ofertës tonë me pretendimin se :

Nuk keni paraqitur Bilancet sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 për tre vitet e fundit 2017-2018-2019 me Ekspert Kontabel.

Nuk keni paraqitur listëpagesat dhe urdhërpagesat për muajin gusht siç kërkohet në DST pasi tre muajt e fundit i takojnë Gusht 2020, Shtator 2020, Tetor 2020, pasi muaji Nëntor 2020 ka afat ligjor deklarimi dhe pagesë datën 20.12.2020 dhe procedura është zhvilluar me 16.12.2020, pra para këtij afati.

Formulari i ofertes ekonomike nuk është paraqitur sipas kërkeses së AK.

Duke mos qenë dakord me vlerësimin e bërë nga AK-jemi drejtuar me ankesë nr. 110 prot., datë 24.12.2020(dërguar dhe me rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të prokurimit publik) kemi paraqitur arsyetimin tonë të mbështetur në prova fakte për kualifikimin e subjektit "Orka" sh.p.k.

Nga sa më lart kërkojmë nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has:



*Pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës tonë.*

*Shfuqizimin e vendimit të KVO-së në të cilin padrejtësisht dhe në kundërshtim të hapur me ligjin kanë bërë skualifikimin e shoqërisë tonë, pasi e shprehur dhe nga vetë Spitali Has me anë të vlerësimit në si subjekt kemi përmbushur të gjitha kriteret teknike, ligjore dhe çdo kriter tjetër të kërkuar nga AK për këtë procedurë prokurimi.*

*Rivlerësimin e procedurës së prokurimit duke bërë korigjimet e duhura në vlerësimin e gabuar dhe tendencioz të KVO-së pasi përdorimi i kriterëve të pa përcaktuara në DST është në kundërshtim të hapur me LPP-në kualifikimin e shoqërisë “Orka” sh.p.k.*

*Skualifikimin e shoqërisë “Trezhnjeva” sh.p.k. pasi ka ofertuar nën kosto ligjore të lejuar.*

*Më datën 03.01.2021 (në SPE rubrika “Kërkesat” na është kthyer përgjigje nga AK) me shkresën nr. 556/3prot., datë 03.01.2021 të autoritetit kontraktor na dërgohet vendimi i KSHA –së në të cilin ka vendosur:*

*Pranimin e pjeshëm të ankesës së paraqitur nga oe “Orka” sh.p.k. në lidhje me vendimin e KVO-së për procedurën e mësipërme të prokurimit.*

*Komisioni I Vlerësimit të Ofertave të bëjë korigjimet e nevojshme duke kualifikuar operatorin ekonomik “Orka” sh.p.k.*

*Njësia e prokurimit të bëjë njoftimet përkatëse për operatorin ekonomik ankimues.*

*Ankesa e operatorit ekonomik “Orka” sh.p.k. u shqyrtua.*

*Kundër këtij vendimi bëhet ankim brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.*

*Pra në shqyrtimin e bërë nga KSHA-ja na është dhënë e drejtë për kërkesat e parashtruara nga na jonë dhe është gjykuar drejt për një vlerësim të padrejtë nga KVO-ja, por edhe KSHA-ja nuk u mor parasysh që subjekti “Trezhnjeva” sh.p.k. ka ofertuar nën koston ligjore të lejuar.*

*Duke qenë se nuk jemi dakord me përgjigjen e dhënë nga AK-ja për pikën 4 kërkojmë skualifikimin e shoqërisë “Trezhnjeva” sh.p.k. pasi ka ofertuar nën koston ligjore të lejuar, kërkojmë nga ana e KPP-së të shfuqizojë vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e subjektit “Trezhnjeva” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi.[...]*

II.5. Me shkresën me nr. 15/2 prot, datë 15.01.2021, protokolluar me tonën me nr. 18/2 prot, datë 19.01.2021, me objekt “Informacion” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.6. Në datën 29.01.2021 Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi në themel ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, si dhe informacionin e dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor lidhur me ankesën objekt shqyrtimi, me vendimin K.P.P. 50/2021, ka vendosur:

- 1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Orka” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr.REF-80922-12-03-2020 me objekt “Shërbim i ruajtjes me roje fizike dhe me sinjal alarmi e kamera sigurie të objekteve të Spitalit Has. Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit 2.000.000 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 16.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has.*
- 2. Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE, sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.*

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Orka” sh.p.k
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.7. Në datën 16.02.2021, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has, ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin elektronik të prokurimeve, duke zbatuar vendimin K.P.P. 50/2021, datë 29.01.2021.

II.8. Në datën 19.02.2021, operatori ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, me pretendimet si më poshtë:

*Nga KVO jemi njoftuar me mesazh elektronik më datë 16.02.2021 për klasifikimin e ofertave dhe një ndër ofertat e skualifikuara është oferta e shoqërisë Trezhnjeva. Kjo ofertë është skualifikuar pa të drejtë pasi plotësojmë kërkesat dhe kushtet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Oferta jonë skualifikohet për këtë arsye: Në bazë të Vendimit 50/2021 datë 29.01.2021. Kundërshtojmë arsyen e skualifikimit pasi nuk qëndron në bazë të ligjit dhe provave. Në përputhjet me të gjitha kërkesat e kërkuara në DT ne kemi paraqitur ofertën tonë ekonomike duke parashikuar sipas ligjit dhe udhëzimit të APP dhe KPP të gjitha detyrimet ligjore sipas kohës së shërbimit. Në vendimin e KPP nuk gjejmë asnjë pikë ku KVO ka shkelur procedurën me vlerësimin e ofertës tonë duke u mbështetur në kërkesat për kualifikim dhe derisa sipas ligjit nuk ka patur asnjë kundërshtim nga firma “Orka” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k për kërkesat për kualifikim.*

*Kërkojmë që titullari i autoriteti kontraktor të urdhërojë KVO të shohë edhe një herë dokumentacionin e paraqitur nga operatorët “Orka” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe t'i skualifikojë këta operatorë për mosplotësim të kriterëve kualifikuese, duke vendosur drejtësin, barazinë dhe transparencën. Sa më sipër kërkojmë marrjen parasysh të ankesës sonë dhe pezullimin e procedurës.*

II.9. Në datën 23.02.2021 autoriteti kontraktor, me anë të shkresës Nr. 87/1 prot., i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k., duke e refuzuar ankesën e tij si dhe e ka vënë në dijeni ankimuesin se ri-vlerësimi i ofertavë nga komisioni i vlerësimit të ofertave është bërë në zbatim të vendimit të KPP nr.50/2021, në datë 29.01.2021.

II.10. Në datën 01.03.2021, operatori ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt të paraqitur pranë autoritetit kontraktor si më poshtë:

### III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese

#### Arsyeton

III.1 Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Treshnjeva” sh.p.k se “Nga KVO jemi njoftuar me mesazh elektronik më datë 16.02.2021 për klasifikimin e ofertave dhe një ndër ofertat e skualifikuara është oferta e shoqërisë Treshnjeva. Kjo ofertë është skualifikuar pa të drejtë pasi plotësojmë kërkesat dhe kushtet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Oferta jonë skualifikohet për këtë arsye: Në bazë të Vendimit 50/2021 datë 29.01.2021. Kundërshtojmë arsyen e skualifikimit pasi nuk qëndron në bazë të ligjit dhe provave. Në përputhjet me të gjitha kërkesat e kërkuara në DT ne kemi paraqitur ofertën tonë ekonomike duke parashikuar sipas ligjit dhe udhëzimit të APP dhe KPP të gjitha detyrimet ligjore sipas kohës së shërbimit. Në vendimin e KPP nuk gjejmë asnjë pikë ku KVO ka shkelur procedurën me vlerësimin e ofertës tonë duke u mbështetur në kërkesat për kualifikim dhe derisa sipas ligjit nuk ka patur asnjë kundërshtim nga firma “Orka” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k për kërkesat për kualifikim.

Kërkojmë që titullari i autoriteti kontraktor të urdhërojë KVO të shohë edhe një herë dokumentacionin e paraqitur nga operatorët “Orka” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe t'i skualifikojë këta operatorë për mosplotësim të kriterëve kualifikuese, duke vendosur drejtësin, barazinë dhe transparencën. Sa më sipër kërkojmë marrjen parasysht të ankesës sonë dhe pezullimin e procedurës”. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.
2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.
6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.

III.1.1. Nga interpretimi në tërësi i dispozitës së sipërcituar del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë për të ankimuar çdo lloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi në tërësi i ankesës të paraqitur nga ankimuesi konstatohet se ky i fundit kundërshton vendimin e autoritetit kontraktor të datës 16.02.2021 lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Treshnjeva” sh.p.k. ndërkohë KPP vëren se skualifikimi i këtij operatori ekonomik është kryer në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik KPP 50/2021 datë 29.01.2021.

III.1.2 Lidhur me pretendimin e ankimuesit për skualifikim të padrejtë KPP gjykon se në rastin konkret pretendimet e parashtruar në ankesë përbëjnë “gjë të gjykuar” për të cilat Komisioni është shprehur në vendimin KP 50/2021 për procedurën në fjalë, vendim i cili në bazë të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përkatësisht nenit 19/1, është administrativisht përfundimtar.

Në këtë kuptim, kjo çështje e pretenduar merr cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo, analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar dhe për rrjedhim, *ipso lege*, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim.

III.1.3. Komisioni thekson faktin se fuqia e “*res judicata*” mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit administrativ përfundimtar, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në shqyrtim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese, dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron organi administrativ në dispozitivin e vendimit të tij.

Autoriteti Kontraktor në rivlerësimin e procedurës të datës 16.02.2021 ka zbatuar, Vendimin 50/2021 të Komisionit të Prokurimit Publik, i cili në pikën 3 të tij ka urdhëruar autoritetin kontraktor të skualifikojë operatorin ekonomik “Treshnjeva” sh.p.k. Në këtë kuptim, Komisioni nuk gjendet përballë asnjë rrethane të re që të mund të legjitimojë ankimuesin në pretendimet e tij lidhur me rivlerësimin e datës 16.02.2021.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet për paraqitjen e ankesës në Komisionin e Prokurimit Publik e rrjedhimisht pretendimet e tij nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Lidhur me pretendimin mbi skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Nazeri 2000” sh.p.k. dhe “Orka” sh.p.k. KPP sjellë në vëmendje të ankimuesit Nenin 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e

*Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr.REF-80922-12-03-2020 me objekt “Sherbim i ruajtjes me roje fizike dhe me sinjal alarmi e kamera sigurie te objekteve te Spitalit Has”,-Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit 2.000.000 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 16.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Has.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 363 Protokoli; Datë 01.03.2021.**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Anëtar</b> <b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Anëtar</b> <b>Lindita Skeja</b>	<b>Anëtar</b> <b>Merita Zeqaj</b>
--------------------------------------	---------------------------------------	--------------------------------------

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**